



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 58912 Prot.

Tiranë, më 03.11.2015

**LËNDA:** PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË SHTETIT NË PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT

**DREJTUAR:** DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE \_\_\_\_\_

ZYRËS ARSIMORE \_\_\_\_\_

**PËR DIJENI :** AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE

**TIRANË**

*Të nderuar drejtorë,*

Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit Nr. 82, datë 22.02.2011 “Për miratimin e Rregullores “Për organizmin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Urdhrit nr. 336, datë 14.07.2011, “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, Udhëzimit nr. 10, datë 03.04.2015 “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit” si dhe të shkresës së MAS nr. 5132 Prot., datë 07.07.2015 “Mbi pranimin e kandidatëve në provimin e shtetit “Mësuesi”, Provimet e Shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin e dytë të vitit 2015 do të zhvillohen pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve, nga java e tretë e muajit Nëntor deri në javën e katërt të muajit Dhjetor 2015.

Kandidatët që do të pranohen në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata që kanë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë dhe programin e studimit të ciklit të dytë (Master i shkencave/ Master i Arteve / Master Profesional) në fushën e edukimit, që përmban lëndët pedagogji dhe psikologji.

Profili ku kandidati do të japë provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë që ka përfunduar kandidati.

DAR/ZA të marrin masat sa më poshtë:

1. Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të kryejnë regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës të cilët:

a) Kanë rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë  
Tel: +355 4 22235300

Email: [zamira.gjini@arsimi.gov.al](mailto:zamira.gjini@arsimi.gov.al)  
Web site: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)


- b) Nuk janë paraqitur në sezonet e mëparshme;
- c) Janë në marrëdhënie pune dhe kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në edukim.
2. Zyrtar Arsimore të plotësojnë listën në format Excel (sipas tabelës bashkëlidhur) me kandidatët fitues, të plotësojnë çdo të dhënë të kërkuar për secilin kandidat në tabelë dhe ta dërgojnë atë në DAR brenda datës 2 Nëntor 2015.
  3. Drejtoritë Arsimore Rajonale të hartojnë listat përfundimtare në format Excel (sipas tabelës bashkëlidhur) duke përfshirë edhe listat e ZA-ve përkatëse me kandidatët aplikantë. Në rast se ZA nuk ka plotësuar çdo të dhënë të kërkuar për kandidatët sipas tabelës, DAR nuk i përfshin këta kandidatë në listën përfundimtare që do të dërgojë në MAS dhe AKP.
  4. DAR-et të dërgojnë zyrtarisht, me postë dhe në rrugë elektronike në Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme në MAS, në adresat elektronike: [novruz.ahmeti@arsimi.gov.al](mailto:novruz.ahmeti@arsimi.gov.al); [marjana.lako@arsimi.gov.al](mailto:marjana.lako@arsimi.gov.al); dhe në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit, në AKP, në adresën elektronike [heliona.bellani@gmail.com](mailto:heliona.bellani@gmail.com), brenda datës 09.11.2015 listat përfundimtare të kandidatëve. **Përtej këtyre afateve, nuk do të pranohet asnjë kandidat për t'ju nënshtruar Provimit të Shtetit.**
  5. MAS së bashku me AKP verifikon listat e dërguara nga DAR/ZA lidhur me të dhënat e plotësuar të kandidatëve. Në rast se DAR-et nuk kanë plotësuar si duhet të dhënat e kërkuara në tabelë për kandidatët për provim shtetit në mësuesi, ose përfshijnë në tabelë kandidatë që nuk plotësojnë kriteret ligjore, MAS nuk i pranon këta kandidatë për provim shteti. Kandidatët që do të pranohen në provimin e shtetit janë të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e parashtruara në shkresën nr. 5132 prot., datë 07.07.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
  6. Të dhënat e dërguara nga DAR-et do t'i shërbejnë AKP për të gjeneruar licencat e kandidatëve që dalin të suksesshëm në provimin e shtetit. Për këtë, DAR-et duhet të saktësojnë të gjitha të dhënat lidhur me: *emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, Nr. ID, datëlindjen, vendlindjen, Universitetin, vitin e mbarimit, Fakultetin, Diplomën Bachelor, Diplomën Master, profilin dhe herën e pjesëmarrjes*. Emërtesat e programeve të studimit të përfunduara nga kandidatët, duhet të jenë të shkruara në mënyrë të plotë dhe në asnjë rast me shkurtime.
  7. Programet orientuese të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit dhe fondi i pyetjeve sipas profileve përkatëse janë në dispozicion të kandidatëve në faqen zyrtare të AKP-së, në adresën [www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al), rubrika "Provimet e Shtetit".
  8. Kandidatët për provimin e shtetit paraqiten në godinën e AKP-së në datën e caktuar, 30 minuta para zhvillimit të provimit, sipas grafikut i cili gjendet në faqen zyrtare të AKP. Kandidatët duhet të kenë me vete dokumentet e mëposhtme:
    - a) një dokument identifikimi (Kartë ID ose Pasaportë) dhe një kopje të tij,
    - b) mandatin e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të AKP,
    - c) faturën për këtë qëllim, e cila gjendet në faqen zyrtare të AKP, rubrika "Njoftime";
    - d) kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej tyre.

Në rast ndryshimi të mbiemrit, kandidati/ja duhet të paraqesë certifikatën përkatëse që vërteton ndryshimin e mbiemrit.

DAR/ZA-të janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur dërguar MAS dhe AKP, si dhe për respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara sa më sipër.




Faleminderit për bashkëpunimin,

PLARENT NDRECA



SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	Marjana Lako		Dt. 23.10. 2015
Përgj. Sektori:	Dritan Sallaku		Dt. 23.10. 2015
Drejtor i AP:	Zamira Gjini		Dt. 23.10.2015